

URDHËR
Nr. 182, datë 19.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E SASIVE MINIMALE TË LEJUESHME QË MUND TË
HIDHEN NË DET PËR DISA FORMA TË PESHKIMIT TË PELAGJIKËVE TË
VEGJËL**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “c”, të nenit 15, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Gjatë aktivitetit të peshkimit për anijet e peshkimit që përdorin trata pelagjike dhe koshilok, lejohen të hidhen në det si hedhurina jo më shumë se 5% e zënieve totale vjetore, sipas përcaktimeve të shtojcës I, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCA I
FORMAT E PESHKIMIT PËR PELAGJIKËT E VEGJËL NË DETIN ADRIATIK

Nënzona gjeografike sipas GFCM	Kodi i veglës të peshkimit	Vegla e peshkimit	Speciet objekt peshkimi
17 dhe 18	OTM, PTM	Trata pelagjike	Açuge, sardele, skumber, stavridh
17	PS	Koshilok	Açuge, sardele, skumber, stavridh